

**Intervista e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Eugen Wollfarth, dhënë
Radios së Departamentit të Gazetarisë, Universiteti i Tiranës**

15 Prill 2013

Pyetje: Sot, ju nënshkruat një memorandum mirëkuptimi me fakultetin tonë. A mund të na tregoni shkurtimisht diçka më shumë rreth tij?

Ambasadori Wollfarth: Ai do të na ndihmojë të mësojmë diçka më shumë rreth rolit të medias deri në kohën e zgjedhjeve, asaj çka ajo raporton dhe çfarë efektesh ka tek lexuesit, shikuesit apo dëgjuesit, për të pasur një media më të mirë për zgjedhjet e ardhshme.

Pyetje: Pse zgjodhët studentët e gazetarisë?

Ambasadori Wollfarth: Universiteti i Tiranës dhe studentët e tij janë pikë së pari në një nivel shumë të mirë profesional dhe akademik dhe për ta bërë këtë punë do të duhen njerëz të rinj dhe të motivuar.

Gjithashtu, studentët përbëjnë të ardhmen, profesionistët e ardhshëm të këtij vendi. Prandaj, është shumë frutdhënëse që ata të mësojnë që në fazat shumë të hershme të dallojnë aspekte të ndryshme dhe të mësojnë se si të menaxhojnë çështje të komplikuar. Menaxhimi i informacionit është i komplikuar, është kompleks, por është edhe kyç për jetën e vendit.

Për çdo gazetar, si për çdo profesion tjetër, mendoj se ndonjëherë është e rëndësishme të mendojë jashtë të menduarit shabllon, njësoj si të shihesh në pasqyrë e të shohësh një njeri të ndryshëm nga vetja, me qëllim që të përmirësohesh e të dallosh pjesët kritike.

Programe si ky mund të jenë shumë konstruktiv. Ata duhet të shihen si shumë konstruktiv për t'u përmirësuar e për të arritur një nivel edhe më të lartë profesionalizmi, në gazetari në këtë rast.

Pyetje: A mendoni se ka ndonjë gjë që mund të ndryshojë për ta bërë më të mirë monitorimin e medias me qëllim përmirësimin e funksionimit të saj?

Ambasadori Wollfarth: Ajo çka kam parë me kalimin e kohës që kam punuar këtu dhe e kam fjalën nga ana personale, është se shumë shpesh do të kisha dëshiruar që të kishte një ndarje më të qartë të fakteve nga opinionet.

Megjithatë, ajo çka kam parë në media është mjaft mirë, sidomos në gazeta. Në shumicën e rasteve, faktet ekzistojnë, disa tentojnë t'i përziejnë ato me opinionet, por kur ke mundësi të shohësh organe të ndryshme mediatike, mund të gjesh fakte dhe prezantime të mjaftueshme faktesh e të nxjerrësh përfundimet e tua.

Në të njëjtën kohë, do të doja t'ju kujtoja që si Ambasador dhe sidomos si Kryetar i Prezencës në Shqipëri, unë kam edhe një ekip që më ndihmon për ta gjetur atë informacion. Kjo nuk është e mundur për një qytetar të zakonshëm, sepse normalisht kur punon, nuk ke edhe aq kohë për ta bërë vetë gjithë këtë punë.

Shërbimi më i madh që gazetarët mund të ofrojnë është që t'u vënë në dispozicion konsumatorëve, shikuesve, dëgjuesve dhe lexuesve informacione relevante, informacione faktike.

Dhe përveç tyre, mundësisht në seksione me vete, të ofrojnë opinione, të cilat edhe prezantohen qartë si të tilla. Dhe kjo e ndihmon jashtëzakonisht shumë vendin, edukimin politik e madje në të gjitha aspektet, në aspektin e civilizimit dhe ekonomisë, pa qenë aspak në kontradiktë.

Pyetje: Si e shihni rolin e medias në Shqipëri? Mendoni se media është në nivelin e duhur profesional si media e vendeve të tjera evropiane?

Ambasadori Wollfarth: Media është në nivel mjaft të mirë, por ka vend për përmirësim. Do të ishte e dobishme të bëhej një ndarje midis faktit që ekziston dhe opinionit që ekziston. Media duhet parë gjerësisht si një sektor i pavarur, dhe do të ishte mirë ndoshta të mendohej më shumë për Klubin e Medias si instrument, duke përfshirë edhe akademikët, për të diskutuar midis gazetarëve çështjet e rëndësishme për gazetari më të mirë. Jam i bindur që nëpërmjet një Klubi aktiv të Medias, nëpërmjet një frymëzimi të përbashkët të gazetarëve, niveli i medias mund të rritet.

Pyetje: Cili do të ishte mesazhi juaj, z. Ambasador, për studentët shqiptarë të gazetarisë?

Ambasadori Wollfarth: Mesazhi im për studentët shqiptarë të gazetarisë është “Shfrytëzoni sa më mirë kohërat në të cilat jetoni. Përmbajuni vlerave të gazetarisë së vërtetë, që do të thotë të jini faktik”. Faktet dhe ndershmëria ecin krah për krah. Me këto vlera në mendje, dhe pa i shtrembëruar ato, mund të fitoni ju e mund të fitojë edhe vendi juaj. Shqipëria, Republika e Shqipërisë është e meriton këtë. Dhe do të doja t'u uroja të gjithë studentëve suksese në karrierën e tyre profesionale.

Faleminderit!